

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istok Municipality of Istog
	Nr. I lëndës 11-351-50350/131	Datë: 02.12.2022	

Bazuar në Ligjin e Ndërtimit, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, neni 3 i Rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba për lëshimin e Lejës ndërtimore për objektin investiv- **Ndërtesë për industri të lehtë** si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura me nr. të kërkesës 11-351-50350 të dt. 25.11.2022 në emër të investitorit ANAHITA sh.p.k. përfaqësuar nga Besar Shoshi nga Kashica, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedis në Istog lëshon këtë:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	ANAHITA sh.p.k. përfaqësuar nga Besar Shoshi nga Kashica		
Adresa:	rr. "8 Maji" nr.14 në Kashicë		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i Projektit:	NDËRTESE PËR PRODHIM S+P+IK NË CERRCË		
Emri i Projektuesit:	1. Masar Kabashi, ida 2. Iliriana Sutaj, ing.nd.dip. 3. Gazmend Krasniqi, idmak 4. Dukagjin Ramqaj, ide 5. Lirie Bekaj, idh		
Adresa:	Studio projektuese "ÇETA general invest group" në Prishtinë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: rr. "Adem Sejdia" pn. ____ në Cerrcë		
Zona(t) Kadastrale: Cerrcë	Nr. i parcelave kadastrale: 00875-0	GPS Koordinatat:

Zona(t) Kadastrale: Cerrcë	Nr. i parcelave kadastrale: 00875-0	GPS Koordinatat:
-------------------------------	-------------------------------------	------------------

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☐	Kategoria II ☒
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☐
Përshkrimi: Ndërtesë afariste me etazhitet S+P+IK(me etazhitet të ngritur h=16.0m) në Cerrcë. Leja e ndërtimit nuk nënkupton që pala nuk duhet të pjsiet me Leje ujore dhe Leje mjedisore për shfrytëzim të ujit nga MMPHI në Prishtinë	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore ANAHITA sh.p.k. përfaqësuar nga Besar Shoshi nga Kashica I lejohet ndërtimi i Ndërtesës për prodhim në Cerrcë në parcelën me nr. 00875-0 ZK Cerrcë dhe sipërfaqe S=16686.0m²,

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
- informata mbi Lejen Ndërtimore
- informatat mbi projektuesin
- informata mbi kontraktuesin
- prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
- një kopje të kësaj leje ndërtimore;
- një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
- një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
- projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
- dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
- librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
- protokollat e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuatë dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me KN, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore, që nënkupton Leje Mjedisore dhe Leje Ujore nga MMPHI në Prishtinë.

Arsyetim

Aplikuesi ANAHITA sh.p.k. përfaqësuar nga Besar Shoshi nga Kashica me numër unik të biznesit 810806862, dhe me nr. të kërkesës 11-351-3706 të dt. 25.01.2022 ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin, - Ndërtësë prodhuese, me etazhitet S+P+1K (me etazhitet të ngritur h=16.0m) në Cerrcë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dokumentacioni pronësor juridik
- Tri kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e II të
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Leje Mjedisore komunale
- Pelqim nga AME në Prishtinë
- Pelqim për Shfrytëzim të brezit rrugor nga MMPHI në Prishtinë
- Pelqim nga KEDS, Hidro DRINI, Ambianti etj

Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: situacioni i ngushtë, dispozita urbanistike e pozicionimit të objektit me koordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

Udhëzim juridik: Pala e paknaqur me këtë vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet MMPHI në Prishtinë Brenda afatit prej 30 ditësh bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori. Ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet: parashtruesit të kërkesës, kësaj Drejtorie, QSHQ, Drejtorisë për inspektim dhe Arkivës

Udh. I sektorit,
Ark. Rexhep Blakaj id,


